



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 15948 prot.

Shkodër, më 05.08. 2025

VENDIM

Nr.51, datë 04.08.2025

“PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR, TË MIRATUAR ME VKB NR. 76, DATË 19.12.2024 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR”, I NDRYSHUAR”

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 04.08.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të neneve 40 dhe 41 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 24.01.2025, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”; VKB nr. 76, datë 19.12.2024, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025–2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar; si dhe në bazë të dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të buxhetit të Bashkisë Shkodër, miratuar me VKB nr. 76, datë 19.12.2024, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025–2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, në Programin AD141 “Planifikimi dhe kontrolli i territorit dhe mjedisi”, në zërin Shpenzime kapitale të patrupëzuara, projekte (artikulli 230), në shumën 20.000.000 (njëzet milionë) lekë.
2. Miratimin e rialokimit të fondit në vlerën 20.000.000 (njëzet milionë) lekë nga buxheti i miratuar me VKB nr. 76, datë 19.12.2024, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025–2027 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar, sipas fishës bashkëlidhur. Ky projekt do të përfshihet në Programin AD141 “Planifikimi dhe kontrolli i territorit dhe mjedisi”, nënprogrami P.AD141.Q5.O1.A10 “Hartimi i studimeve dhe projekteve teknike në infrastrukturë rrugore dhe objekte të ndryshme.”

3. Burimi i financimit për fondin do të jetë nga riallokimi i fondeve të mbetura të trashëguara (gjendje) nga viti 2024, të përfshira në buxhetin e vitit 2025, miratuar me VKB nr. 76, datë 19.12.2024, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025–2027 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar, si më poshtë:

Pakësim të trashëguara 2024

000/lekë

Nr	Nr. Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Art.602 Shpenzime operative	Art.604 Transferta të brendshme	Art.609 Fondi rezerve	Institucioni likuidues
1	AH141 Kap.1	Fondi Rezervë			6,631	Bashkia Shkodër
2	AF141 Kap.5	P08220.Q1.O3.A7 Shpenzime për mirëfunksionimin e plotë të Teatrit Migjeni	1 422			
3		P8220.Q1.O3.A9 Shpenzime për sigurimin e funksionimit të plotë të Qendrës Kulturore "P.Gaci" dhe Qendra Atelie	578			
4		P08220.Q1.O3.A12 Realizimi i Aktiviteve të Qendrës Kulturore "Pjeter Gaci"	478			
5		P08220.Q1.O3.A15. Realizimi i Aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Kulturës	47			
6		P08220.Q1.O3.A20 Realizimi i aktiviteteve të Galerisë së Arteve	36			
7		P08220.Q1.O3.A24. Shërbime fonie, skene dhe ndriçimi për aktivitetet e kulturës	1,365			

8	AI141 Kap.5	P.9230.Q1.O1.A24. Mbështetje e Ndërmarrjes së Trajtimit të Studentëve		9,443		
		TOTALI	3,926	9,443	6,631	

Shtesë viti 2025

000/lekë

Nr	Nr. Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Art.230 Shpenzime kapitale të patrëpëzuara	Institucioni likuidues
1	AD141 Kap 1	P.AD141.Q5.O1.A10 Hartimi i studimeve dhe projekte teknike në infrastrukturë rrugore dhe objekte të ndryshme <i>Projektim</i>	6,631	Bashkia Shkodër
	AD141 Kap 5		13,369	
		TOTALI	20,000	

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Miraturar me 29 vota

Vota Pro 29
Vota Kundër 9
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 05.08.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj




Adresa: Rr. "13 Dhjetori", Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiaishkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiaishkoder.gov.al